



Prishtinë, 23 shkurt 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_796\_2016

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-618-2014 dt. 29 prill 2014 për lëshimin e Vendimit për Njoftimin mbi Autorizimin Preliminar për shoqërinë "KelKos Energy Peja" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji në Lumin Lumëbardhi i Pejës që përbëhet prej (5) njërive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Kuqishta 4.5 MW, HC Drelaj I 4.6 MW, HC Drelaj II 4.4 MW, HC Shtupeq 6.5 MW HGU Rugova 40.5 MW, me kapacitet total prej 60.5 MW, KK Peja, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për HC Shtupeq me kapacitet të instaluar prej 6.5 MW, të datës 13.07.2015 të shoqërisë "KelKos Energy Peja" sh.p.k., me adresë "Ahmet Krasniqi" Blloku C1/b,15., Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 23 shkurt 2016 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "KelKos Energy Peja " sh.p.k.. dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Shtupeq me kapacitet të instaluar prej 6.5 MW, në lumin Lumëbardhi i Pejës, komuna e Pejës.
- II. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
- III. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesit Publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.





## Arsyetim


- ZRRE me datë 13.07.2015 nga shoqëria “KelKos Energy Peja” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Shtupeq me kapacitet të instaluar prej 6.5 MW, në lumin Lumëbardhi i Pejës, komuna e Pejës.
  - Bordi i ZRRE-së me datë 29 prill 2014, shoqërisë “KelKos Energy Peja” sh.p.k., i ka lëshuar Vendimin V-618-2014 për Njoftimi mbi Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
  - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit V-618-2014 dt. 29 prill 2014 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën është lëshuar Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, shoqërisë “KelKos Energy Peja” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


### Bordi i ZRRE-së:

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar

  
Arsim Janova, anëtar

  
Qemajl Mustafa, anëtar

  
Besim Sejfi, anëtar

### Vendimi iu dërgohet:

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së